



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.15/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Armend Berisha, anëtarë, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj xxxxx xxxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-226, i njëjti të Komisioni Disiplinor ka marr numrin KGJK/KD/10/2017, për pretendim për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Shkelje e Kodit të Etikës te Sjelljes Profesionale për Gjyqtar, në seancën dëgjimore të mbajtur me prezencën e palëve, më datën 28.09.2017, në bazë të nenit 15 pika 5 të Ligjit Nr.05/L-033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor te Kosovës, merr këtë:

V E N D I M

PUSHOHET procedura disiplinore sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-226, për xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx, sepse pretendimi për sjellje të pahijshme sipas këtij raporti është **parashkruar**.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur raportin përfundimtar Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më të cilin xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx e ka akuzuar për sjellje te pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme te etikes sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Shkelje e Kodit të Etikës te Sjelljes Profesionale për Gjyqtar.

Hetimin disiplinor ZPD e kishte filluar sipas detyrës zyrtare lidhur me pretendimet për vonës të hartimit të vendimit gjyqësor në lëndën gjyqësore C.nr.766/08.Mbi bazën e provave të siguruara gjatë hetimit disiplinor ZPD kishte hapur hetimin disiplinor, kishte intervistuar gjyqtarin xxxxx, dhe në fund ka hartuar raporti përfundimtar numër ZPD-2017-226, më të cilin ka rekomanduar sanksion disiplinor për gjyqtarin xxxx xxxxx për sjellje të pahijshme të pretenduara në këtë raport.

Në seancën dëgjimore të Komisionit disiplinor të mbajtur me datë 28.09.2017, ZPD e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar.

Gjyqtari xxxx xxxx në seancën e Komisionit Disiplinor deklaroj se në tërësi mbetet pran deklaratës së dhënë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor me një ndryshim të vogël se nuk ka pasur vonës në përpilim, por vetëm në dorëzimin e lëndës poshtë. E gjithë kjo sipas gjyqtarit xxxxxx ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe me lëndë, angazhimit që lëndët të kryhen me profesionalizëm, dhe se kjo lëndë ju kishte përzier me lëndët e tjera. Lidhur me këtë vonës e kishte njoftuar edhe kryetarin e Gjykatës dhe në fund vetë personalisht ishte angazhuar dhe lëndën e kishte gjetur dhe ekspedituar.

Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore me datë 28.09.2017, ku ka shqyrtuar pretendimet e Raportit Përfundimtar të ZPD-së me numër ZPD-2017-226, për xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx.

Komisioni, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të Raportit Përfundimtar të ZPD-së me numër ZPD-2017-226, dëgjimit të deklaratës së gjyqtarit xxxx të dhënë në seancë, konstatoj dhe njëzëri vendosi se pretendimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, konform nenit 15 paragrafi 1 (5) të Ligjit Nr.05/L-033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, **është parashkuar**.

Sjellja e pahijshme e pretenduar sipas Raportit Përfundimtar të ZPD-së numër ZPD-2017-226, për lëndën C.nr.766/08, ka ndodhur kur gjyqtari xxxxx xxxxxx me datë 27 prill 2015 kishte mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, 15 ditë është afati ligjor për hartim të aktgjykimit, kështu që i bie prej 12 maj 2015 e deri me 28.09.2017 kur Komisioni ka mbajtur seancën dëgjimore, kanë kaluar me shumë se dy vite siç ka përcaktuar nenit 15 paragrafi 1 (5) të Ligjit Nr.05/L-033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe njoftimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për përmirësim të lëshimit teknik i datës 08 korrik 2015, shpallur në gazetën zyrtare Nr.18/13 korrik 2015, Prishtinë, citoj” Neni 15 paragrafi 1(5) të Ligjit Nr.05/L-033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili është publikuar në gazetën zyrtare me 30 qershor 2015, është hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në gazetë zyrtare, thotë “Procedura nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komision pasi të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe pesë (5) vite nga dita e shkeljes së supozuar” e përmirësuar me Njoftimin për përmirësim lëshim teknik në Ligj nga Kuvendi i Kosovës dhe publikuar në gazetë zyrtare të Kosovës Nr.18/13 korrik 2015”, Neni 15 I ligjit I cili plotëson dhe ndryshon nenin 36 te ligjit bazik, paragrafi 5, rreshti tretë, numri pesë(5), zëvendësohet me numrin dy(2).

Në bazë të nenit 15 paragrafi 1 (5) të Ligjit Nr.05/L-033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në disipozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.15/2017, date 28.09.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor

Gjyqtari, Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor
të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh
nga dita e pranimit të Vendimit.

Vendimi u dërgohet;

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Shkelzen Maliqi, drejtor i SKGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxx xxxx, kryetar i Gjykatës Themelore në xxxx;
- Xxxxx xxxxx, gjyqtar i Gjykatës Themelore në xxxxx;
- Administratës se Personelit në Sekretariatit e SKGJK-së;